

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Bianco Brillante"-sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", me vullnetin e tij te lire, te shprehur dhe te pavesuar me nenshkrimin e ketij Akt Themelimi ortaku i vetem:

- 1. Z.Gezim Gjonca**, lindur me 01.02.1972, ne Tepelene dhe banues ne Sarande madhore me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr.personal H202011830, ne cilesine e ortakut themelues

Vendosi te krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "**Bianco Brillante**" sh.p.k me akt themelimi si vijon:

EMERTIMI

NENI 1

1.1 Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "**Bianco Brillante**" sh.p.k.

1.2 Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

2.1 Shoqeria e ka seline qendrore ne Rrugen "**Frang Bardhi**", ndertesa nr.122, Hyrja 10, Apartamenti nr.1, Selite, Farke, 1044, Tirane, me nr.pasurie Nr.110/45-N6, vol.355, fq.171, dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

3. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

3.1 Aktivitet i telemarketingut (web call center), shitje online, prenotimi online, sherbim klienti etj.

3.2 Qender prenotimi dhe sherbimesh turizmi dentare, ortodontike, etj.



3.3 Bashkpunimi me kompani e subjekte te te njejtës fushe si dhe ndermjëtesime konsulencia per vendosjen e shoqerive te huaja ne Shqiperi.

3.4 Projektimin,realizimin, dhe mirembajtjen e sistemeve dhe/ose aparaturave informatike, te telekomunikacionit, dhe/ose dixhitale.

3.5 Projektimin, realizimin, dhe/ose mirembajtjen/menaxhimin e regjistrave (baza te dhenash), trajtim te dhenash, duke perfshire, por pa kufizuar: realizimin dhe/ose tregtimin e te dhenave me pelqimin paraprak te testatorit te te dhenave; dhe/ose ngritjen dhe menaxhim in e call center(ave).

3.6 Gjithashtu shoqeria pa u kufizuar sa me siper, do te mund te kryeje çdo aktivitet tjeter ekonomik, tregtar, financiar, qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE NENI 4

4.1 Shoqeria "**Bianco Brillante**" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

KAPITALI I SHOQERISE NENI 5

5.1. Kapitali i shoqerise "**Bianco Brillante**" sh.p.k perbehet nga para me nje vlere te barabarte me 10 000 leke. Ky kapital ndahet ne 1 kuote me vlere 10.000 leke, e cilat zotërohet **100 % nga Ortaku i Vetem, Z.Gezim Gjonca.**

5.2. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

5.3.Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithe ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

5.4.Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te asamblese se ortaeve organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

ORGANI VENDIMMARRES



NENI 6

6.1. Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

6.2. Ortaku i Vetem, vendos per çeshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

6.3. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem duhet te regjistrohen ne librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT NENI 7

7.1. Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesi per miratim tek ortaku i vetem i shoqerise,;
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) te kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) te raportoje perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

7.2. Administratori është i detyruar që të marrë vendim, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

7.3. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

7.4. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

7.5. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretet e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretet nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR NENI 8

8. Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare, me mundësi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se kryhen shkelje, vërehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyrës.

NENI 9

9. Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjisllacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

10. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

NENI 11

11. 1 Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjisllacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr. 9901 datë, 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

NENI 12

12.1 Akti i Themelimit u përplua në 4 kopje, me vlerë të njëjte juridike.

ORTAKU I VETEM

Z.Gezim Gjonca

Gezim Gjonca
